

Mirëqenia Personale dhe Shoqërore e Evropianëve

Rezultatet Kryesore nga Raundi 6 i
Sondazhit Social Evropian (SSE)

Seritë e
raportimeve
të rezultateve
kryesore të SSE-s

Edicioni

5

Përdorimi i të dhënave të Sondazhit Social Evropian Të dhënat dhe dokumentacioni

Sondazhi Social Evropian Konzorciimi për Infrastrukturë për Hulumtime Shoqërore Evropiane (SSE ERIC) siguron qasje falas në të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e tij. Të dhënat mund t'i qaseni dhe shkarkoni nga www.europeansocialsurvey.org.

Nisma të veçanta janë zhvilluar për të promovuar qasjen dhe përdorimin e databazave në rritje, duke përfshirë EduNet dhe NESSTAR, të cilat janë të disponueshme nëpërmjet faqes së internetit të SSE.

EduNet

Vegla për mësim onlajn SSE, EduNet, është

zhvilluar për përdorim në arsimin e lartë. Platforma ofron shembuj praktikë dhe ushtrime të dizajnuara për të udhëhequr përdoruesit gjatë proceseve hulumtuese, nisur nga problemi teorik deri në interpretimin e rezultateve statistikore. Dhjetë tema janë në dispozicion duke përdorur të dhëna nga SSE.

NESSTAR

SSE Paketa për Analiza Online përdor NESSTAR - një platformë për analizim të të dhënave onlajn. Dokumentacioni për ndihmë në përdorimin e NESSTAR është në dispozicion nga Shërbimi i të Dhënave të Shkencave Shoqërore Norvegjeze (www.nesstar.com).

Sondazhi Social Evropian (SSE) gjithmonë ka synuar të promovojë përdorimin e treguesve shoqëror, bazuar në vlerësimet personale të qytetarëve për shoqërinë, me qëllim që të plotësojnë matësit e rezultateteve më të vështira ekonomike dhe sociale.

SSE 6 moduli i Mirëqenies Personale dhe Sociale e plotëson këtë synim duke dekonstruktuar mirë konceptin e përgjithshëm të 'mirëqenies' dhe duke ofruar një ekzaminim unik dhe të detajuar ndër-kombëtar të këtij koncepti kompleks. Për më tepër, ofron shumë

më tepër hollësi sesa vetëm një pyetje për të matur mirëqenien, Sondazhi Social Evropian u lejon analistëve të sugjerojnë implikime më të detajuara të politikave në një temë e cila ka marrur vëmendje dhe mbetet temë e spikatur në debatet në mbarë Evropën.

Dëshiroj të falënderoj ekipin e hartimit të pyetësorit origjinal dhe autorët e kësaj broshure për kontributin e tyre të shkëlqyer në këto debate.

Dr. Rory Fitzgerald

Drjtoreshë SSE ERIC

Autorët e këtij edicioni:

Karen Jeffrey është hulumtuese në Fondacionin Ekonomiksi i Ri, Britani të Madhe.

Saamah Abdallah është një Hulumtues i Lartë në Fondacionin Ekonomiksi i Ri, Britani të Madhe

Annie Quick është Hulumtuese në Fondacionin Ekonomiksi i Ri, Britani të Madhe.

Anëtarët e ekipit për dizajnimin e pyetësorit janë:

- Felicia Huppert, Universiteti i Kembrixhit, Britani të Madhe
- Nic Marks dhe Juliet Michaelson, Fondacioni Ekonomiksi i Ri, UK
- Johannes Siegrist, Universiteti i Dusseldorfit, Gjermani
- Carmelo Vazquez, Universiteti Complutense, Spanjë
- Joar Vittersø, Universiteti i Tromsø, Norvegji

Mirëqenia Personale dhe Sociale e Evropianëve

Rezultatet Kryesor nga Raundi 6 i Sondazhit Social Evropian

Karen Jeffrey, Saamah Abdallah dhe Annie Quick

Hyrje

Në përgjithësi, njerëzit do të pajtoheshin se një shoqëri ku më shumë njerëz kanë një përvojë pozitive të jetës, ose mirëqenie më të madhe, është diçka që ia vlen të synohet. Kjo sugjeron se politikëbërësit duhet të interesohen se si të krijojnë kushtet që kjo të ndodhë. Për një kohë të gjatë, ka pasur një supozim të përhapur së dhënia prioritetit i rritjes ekonomike është mënyra më e mirë për të maksimizuar mirëqenien (p.sh. OECD, 2006). Megjithatë, kjo pikëpamje po kontestohet gjithnjë e më shumë.

Meqë studimet tregojnë se marrëdhënia pozitive midis rritjes ekonomike dhe mirëqenies së vetë-raportuar është e vogël ose e papërfillshme, pas një niveli mjaft të ulët të pasurisë (Layard, 2005; Bartolini & Bilancini, 2010; Easterlin, 2013), bëhet e qartë se është i nevojshëm një kuptim më i mirë i asaj së çka kontribuon në mirëqenie. Të dhënat për mirëqenien luajnë një rol të rëndësishëm. Vetëm me informacion sistematik dhe të detajuar për përvojat e qytetarëve në aspekte të ndryshme të mirëqenies, të mbledhura së bashku me informacione më të gjera rreth jetës së qytetarëve, mund të shpresojmë se kemi kuptuar sa duhet se çka ndikon në mirëqenie dhe pastaj të zhvillojmë politika të dizajnuara për ta maksimizuar atë.

Ka përparime të mëdha në këtë front, me të dhëna të besueshme kombëtare për

mirëqenien që mbledhen nga organet zyrtare kombëtare në shumë vende Evropiane (Abdallah dhe Mahony, 2012). Moduli i Mirëqenies Personale dhe Sociale i përfshirë së pari në Raundin 3 të Sondazhit Social Evropian (SSE), dhe përsëritur në Raundin 6, është një kontribut i rëndësishëm në këtë grumbull informacioni.

Të dhënat nga raundi 6 i SSE,ⁱ u mbledhën përmes një serie me orë të gjata intervistash, në person, me individë të moshës 15 vjeçare ose më të vjetër në 29 vende Evropiane,ⁱⁱ duke ofruar vetëm më pak se 54,600 përgjigje unike. Të anketuarit e sondazhit janë përzgjedhur duke përdorur saktë mostrën e probabilitetit të rastësishëm, me një target minimale të përgjigjeve prej 70%, për të provuar dhe për të siguruar që janë marrë mostra kombëtare përfaqësuese.ⁱⁱⁱ Përktimi i cilësisë së lartë të pyetjeve nga ana e SSE^{iv} dhe mostrimi sistematik ndërkombëtar mundëson të bëhen krahasime të besueshme ndër-shtetërore.

Kjo broshurë përshkruan gjetjet kryesore nga analiza fillestare e këtyre të dhënave,^v duke përfshirë një eksplorim të natyrës shumë dimensionale të mirëqenies; diskutime se si ndryshojnë aspekte të ndryshme të mirëqenies në të gjithë Evropën; dhe një shqyrtim të marrëdhënies midis të ardhurave dhe mirëqenies.

A është mirëqenia më shumë sesa kënaqësia me jetën?

Shumë studime mbështeten në një matës të vetëm të lumturisë apo kënaqësisë së jetës si treguesi i vetëm i mirëqenies (Abdallah dhe Mahony, 2012). Megjithatë, studimet ekzistuese teorike (Vittersø, et al., 2010) dhe empirike (Huppert & So, 2009) kanë sugjeruar se mirëqenia është një koncept shumëdimensional dhe matës të tillë të vetëm nuk mund të përfshijnë kompleksitetet e saj. Përfshirja e një game të pasur të matësve të mirëqenies personale dhe sociale në Raundin 6 të SSE mundëson një eksplorim të plotë të kësaj hipoteze.

Duke përdorur një kombinim të modeleve teorike dhe analizave statistikore,^{vi} kemi identifikuar gjashtë dimensionet kyçe të mirëqenies, të përbërë nga 35 nga elementet brenda Modullit të Mirëqenies Personale dhe Sociale (shih Tabelën 1). Dimensionet janë:

- Mirëqenia e vlerësuar, e cila mbulon vlerësimet e përgjithshme të individëve se sa mirë po shkon jeta e tyre, duke përfshirë ndjenjën e të qenurit i kënaqur me jetën dhe të ndjenurit i lumtur në përgjithësi.
- Mirëqenia emocionale, e cila përfshin ndjenja pozitive të përditshme si lumturia dhe shijimi i jetës, si dhe mungesa e ndjenjave negative si ankthi dhe depresioni.
- Funksionimi, i cili përfshin ndjenjat e autonomisë, kompetencës, angazhimit, kuptimit dhe qëllimit, vetë- vlerësimit, optimizmit dhe rimarrja e vetes.
- Vitaliteti, i cili përfshin të fjeturit mirë, të ndjehurit energjik dhe ndjehurit i aftë për t'u përballur me sfidat që paraqet jeta.
- Mirëqenia e komunitetit, që ka të bëjë me ndjenjat e një individi për komunitetin në të cilin jeton, duke përfshirë besimin tek njerëzit e tjerë, të ndjehurit i mbështetur nga pjesëtarët e komunitetit dhe përjetimi i një ndjenjë të fqinjësisë së mirë.
- Marrëdhënie mbështetëse, e cila lidhet me ndjenjën e individëve që ka njerëz në jetën e tyre që i ofrojnë mbështetje, shoqëri, vlerësim dhe me të cilët mund të diskutohen çështjet intime.

Tabela 1: Elementet nga moduli i mirëqenies të grupuara sipas dimensionit të mirëqenies me të cilën ato lidhen

DIMENSIONI I MIRËQENIES	SSE ELEMENTET E ANKETËS
Mirëqenia e vlerësuar	Sa të kënaqur me jetën si një e tërë
	Sa i lumtur je ti
Mirëqenia emocionale	U ndjeve i/e trishtuar, sa shpesh javën e kaluar
	Ndjeve në depresion, sa shpesh javën e kaluar
	Shijove jetën, sa shpesh javën e kaluar
	Ishit të lumtur, sa shpesh javën e kaluar
	Ju ndjeheshit në ankth, sa shpesh javën e kaluar
	Ju ndjeheshit të qetë dhe në paqe, sa shpesh javën e kaluar
Funksionimi	I lirë të vendosi se si të jetoj jetën time
	Pak shanse për të treguar se sa i aftë jam
	Ndjehem i arrirë nga ajo që bëj
	I interesuar në atë që po bëni
	I lodhur nga ajo që po bëj
	I entuziazmuar nga ajo që po bën
	Ndjej se atë që bëj në jetë është vlefshme
	Kam një drejtim në jetën time
	Gjithmonë optimist për të ardhmen time
	Ka shumë gjëra në të cilat jam i mirë
	Në përgjithësi ndihem shumë pozitiv për veten time
	Nganjëherë ndjehem sikur jam një dështim
	Kur gjërat shkojnë keq në jetën time, merr shumë kohë për t'u kthyer në normale
	Merrem me probleme të rëndësishme
Vitaliteti	Ndjeva gjithçka bëri një ndryshim, sa shpesh javën e kaluar
	Gjumi ishte jo i mirë, sa shpesh javën e kaluar
	Nuk mund t'i shty gjërat, sa shpesh javën e kaluar
	Kisha shumë energji, sa shpesh javën e kaluar
Mirëqenia e komunitetit	Shumica e njerëzve mund të besohen / nuk mund të jem shumë i kujdesshëm
	Njerëzit përpiqen të përfitojnë nga unë
	Shumicën e rasteve njerëzit të ndihmojnë
	Ndjeheni se njerëzit në zonën tuaj i ndihmojnë njëri-tjetrin
	Ndjeheni afër njerëzve në zonën lokale
Marrëdhënia mbështetëse	Me sa persona mund t'i diskutoni çështjet intime
	Ndjeheni të vlerësuar nga ata që i keni pranë
	Merr ndihmë dhe përkrahje
	Ndjeheshit i vetmuar, sa shpesh javën e kaluar

Për çdo dimension, kemi llogaritur një rezultat të indeksit^{vi}, duke përdorur rezultatet e përgjigjeve në pyetjet brenda dimensionit (shih Tabelën 1). Tabela 2 tregon vendet sipas pikëve mesatare të tyre për secilin dimension të mirëqenies. Për të mundësuar identifikimin e shpejtë të vendeve të renditura më lartë dhe më ulët, rezultatet janë koduar me ngjyra duke përdorur një sistem të trafikut në mënyrë që jeshile tregon mirëqenien më të lartë brenda çdo dimensionit dhe e kuqja tregon mirëqenien më të ulët.

Në Tabelën 2, vendet janë të renditura nga më të lartat në më të ulët sipas vlerësimit të mirëqenies vlerësuese, për lehtësinë e krahasimit me trendet e vendeve të renditura më lartë dhe më ulët në dimensionet e tjera të mirëqenies. Mund të shohim se vendet e renditura më lartë në mirëqenien vlerësues, renditen gjithashtu lartë në pesë dimensionet e tjera të mirëqenies; dhe vendet me mirëqenien


vlerësuese më të ulët përgjithësisht janë të renditur më ulët në pesë dimensionet e tjera. Megjithatë, ky trend nuk është tërësisht i qëndrueshëm, dallimi më i theksuar vërehet kur krahasojmë midis dimensionit të mirëqenies vlerësuese dhe mirëqenies së komunitetit dhe dimensionet e vitalitetit.

Të dhënat e zgjedhura nga Tabela 2 janë riprodhuar në diagramet e radarëve në Figurën 1, duke siguruar një pasqyrë në nivel vendi. Këto fotografi nxjerrin në pah se ku ekzistojnë mospërputhje midis rezultatit të një vendi në mes dimensionit të mirëqenies vlerësuese dhe dimensioneve të tjera të mirëqenies, këto trende të ndryshimeve nuk janë uniformë në të gjitha vendet. Për shembull, diagramet e radarëve për Federatën Ruse, Danimarkën dhe Bullgarinë zbulojnë trende mjaft të ndryshme në dimensionet e mirëqenies, këto vende renditen më lartë dhe më ulët.

Tabela 2: Rezultatet mesatare të standardizuara në gjashtë dimensione të mirëqenies, sipas vendit

	Mirëqenia e vlerësuar	Mirëqenia emocionale	Funksionimi	Vitaliteti	Mirëqenia e komunitetit	Marrëdhënia mbështetëse
Danimarkë	0.68	0.36	0.32	0.05	0.10	0.30
Norvegji	0.53	0.39	0.19	0.02	0.23	0.25
Zvicër	0.52	0.16	0.21	0.17	0.14	0.23
Islandë	0.51	0.28	0.19	0.05	0.42	0.19
Finlandë	0.51	0.22	0.16	-0.06	-0.03	0.10
Holandë	0.46	0.20	0.16	-0.04	0.04	0.16
Suedi	0.41	0.24	0.13	0.00	0.15	0.22
Izrael	0.31	0.04	0.17	0.11	0.03	0.07
Gjermani	0.31	0.18	0.18	0.10	0.08	0.24
Belgjikë	0.26	0.04	0.07	-0.06	-0.02	0.01
Mbretëri e Bashkuar	0.23	0.11	0.07	-0.07	-0.02	0.05
Spanjë	0.16	-0.04	-0.02	-0.14	0.06	0.07
Poloni	0.11	0.00	0.10	0.02	-0.08	0.09
Sloveni	0.08	0.27	0.10	0.06	-0.01	0.08
Qipro	0.07	-0.05	0.07	0.12	-0.14	0.16
Irlandë	0.03	0.23	0.12	0.09	0.19	0.00
Francë	-0.01	-0.01	0.04	0.07	-0.06	0.09
Itali	-0.06	-0.16	-0.01	-0.06	-0.06	-0.14
Slovaki	-0.12	0.03	-0.14	0.03	-0.01	-0.15
Republikë Çeke	-0.14	-0.01	-0.17	-0.03	-0.14	-0.24
Estoni	-0.17	-0.06	-0.01	0.06	-0.08	-0.09
Kosovë	-0.21	-0.17	0.14	0.07	0.16	-0.06
Portugali	-0.31	-0.07	-0.09	0.15	0.01	-0.10
Lituani	-0.36	-0.28	-0.17	-0.12	-0.12	-0.12
Shqipëri	-0.38	-0.37	0.01	-0.05	-0.14	-0.10
Federata Ruse	-0.40	-0.23	-0.83	-0.04	-0.45	-0.33
Hungari	-0.49	-0.30	-0.14	-0.18	0.21	-0.16
Ukrainë	-0.55	-0.23	-0.18	-0.04	-0.04	-0.25
Bulgari	-0.88	-0.24	-0.17	0.03	-0.08	0.06

Figura 1: Krahasimi i rezultateve mesatare të standardizuara në gjashtë dimensione të mirëqenies në një mostër të vendeve



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Edhe pse renditja e një vendi në dimensionin e mirëqenies vlerësuese duket të jetë një parashikues i relativisht i mirë i renditjes së këtij vendi në dimensionet e tjera të mirëqenies, analiza e mësipërme sugjeron se në disa vende disa nga dimensionet sillen ndryshe nga njëra-tjetra dhe se renditja në një dimension jo domosdoshmërisht parashikon renditje në dimensione të tjera. Prandaj, mund të ketë vlerë qasja ndaj mirëqenies si një koncept shumëdimensional.

Një hipotezë parasheh që, pavarësisht dallimeve të paraqitura në Tabelën 2, mirëqenia vlerësuese ofron një pasqyrim të mirë për mirëqenien e përgjithshme, sepse të anketuarit i konsiderojnë dimensionet e saj dhe i përmbledhin ato në një përgjigje të vetme. Duke supozuar se secila nga dimensionet e mirëqenies ka peshë të barabartë, do të prisnim që renditja e vendit në mirëqenien vlerësuese të ndiqte një trend të ngjashëm me renditjen e vendit sipas pikëve mesatare të pesë dimensioneve të tjera. Në Tabelën 3 ne e testojmë këtë hipotezë duke krahasuar dallimet në renditje në mes të këtyre dy matësve. Ne shohim se në gjashtë nga 29 vendet e vlerësua, ka një ndryshim në pozicionin e renditur prej gjashtë apo më shumë vendesh, duke sugjeruar disa mospërputhje midis matësve.

Për të testuar nëse këto mospërputhje mund të shpjegohen me një supozim të pasaktë se secila nga pesë dimensionet e mirëqenies ka peshë të barabartë, kemi kryer analiza të ndjeshmërisë^{viii} për të testuar nëse mund të përdoren kombinime të tjera të peshave, dhe kur nxerrim mesataren e ponderuar, rezultatet do të jenë sa më afër rezultatit të mirëqenies vlerësuese. Kur është aplikuar mesatarja e ponderuar,^{ix} dy matësit u ofruan sa i përket renditjes, megjithatë, kishte dallime thelbësore. Për shembull, për Irlandën dhe Zvicrën dallimi në pozicionin e renditur në të dy matësit ndryshonte më shumë se pesë vende dhe pozicioni i Sllovenisë ndryshonte nëntë vende.

Kjo sugjeron që, gjersa mirëqenia vlerësuese duket të jetë mjaft përfaqësuese për mirëqenien e përgjithshme, nuk mund të përfaqësojë një përmbledhje të të gjitha dimensioneve përkatëse. Duhet të bëhen hulumtime të mëtejshme për të shqyrtuar nëse koncepti i mirëqenies vepron në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme; për shembull, për të përcaktuar nëse pesha të ndryshme duhet të aplikohen në vende të ndryshme ose për të siguruar që një dimension i rëndësishëm i mirëqenies në një vend të caktuar nuk mungon në këtë analizë.

Tabela 3: Krahasimi i vendeve me mesatare të standardizuara të mirëqenies vlerësuese me mesatare të rezultateve të standardizuara të pesë dimensioneve të tjera

	Rezultatet mesatare të 5 dimensioneve të tjera	Dallimi nga renditja e mirëqenies vlerësuese		Rezultatet mesatare të 5 dimensioneve të tjera	Dallimi nga renditja e mirëqenies vlerësuese
Danimarkë	0.23	-	Irlandë	0.12	↓↓↓
Norvegji	0.21	-	Francë	0.03	↓
Zvicër	0.18	-	Itali	-0.09	↑↑
Islandë	0.23	↓	Slovaki	-0.05	↑
Finlandë	0.08	↑↑↑	Republikë Çeke	-0.12	↑↑
Holandë	0.10	↑	Estoni	-0.04	-
Suedi	0.15	-	Kosovë	0.03	↓↓↓
Izrael	0.08	↑	Portugali	-0.02	↓↓
Gjermani	0.16	↓↓	Lituan	-0.16	↑↑
Belgjikë	0.01	↑↑↑	Shqipëri	-0.13	-
Mbretëri e Bashkuar	0.03	↑	Federata Ruse	-0.38	↑
Spanjë	0.01	↑↑↑	Hungari	-0.11	↓
Poloni	0.03	↑	Ukrainë	-0.15	-
Sloveni	0.10	↓↓	Bulgari	-0.08	↓↓↓
Qipro	0.03	↓			

Dallimi në pozitën e renditur	Më e lartë se mirëqenia vlerësuese	Më e ulët se mirëqenia vlerësuese
<2	-	-
2-3	↑	↓
4-5	↑↑	↓↓
>5	↑↑↑	↓↓↓

Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Dallimet në kënaqësinë e jetës mes familjeve me të ardhurat më të larta dhe më të ulëta

Viteve të fundit është rritur shqetësimi për pabarazinë ekonomike (Wilkinson dhe Picket, 2011, Kombet e Bashkuara, 2013, Kersley dhe Shaheen, 2014). Ky shqetësim është gjithashtu i rëndësishëm për mirëqenien. Politika nuk duhet të synojë vetëm për të maksimizuar mirëqenien mesatare kombëtare, por edhe për të reduktuar pabarazitë në mirëqenien (Komisioni Evropian, 2013). Në vitin 2014, Grupi Parlamentar i të Gjitha Partive të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, kërkoi "një strategji kombëtare për promovimin e mirëqenies, ngushtimin e pabarazive të mirëqenies dhe trajtimin e mirëqenies së ulët" (Berry, 2014).

Një mënyrë për të vlerësuar pabarazitë në mirëqenie është të shikojmë mirëqenien e të anketuarve në grupe të ndryshme të të ardhurave, për shembull

dallimi në mirëqenien midis atyre në 20% të popullsisë me të ardhurat më të ulëta neto të familjes (kuintili i parë i të ardhurave), dhe ato në 20% të popullsisë me të ardhurat më të larta neto të familjes (kuintili i pestë i të ardhurave).


Në i kemi krijuar matësit vlerësues, siç janë treguesit e kënaqësisë së jetës, duket të jenë tregues të mirë, edhe pse tregues jo të plotë të mirëqenies së përgjithshme. Megjithatë, për lehtësimin e interpretimit, në analizën në vijim përdorim pyetjen e kënaqësisë së SSE, e cila pyet: "Duke marrë parasysh të gjitha gjërat, sa jeni të kënaqur me jetën tuaj në tërësi në ditët e sotme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur këtë kartelë, ku 0 do të thotë shumë të pakënaqur dhe 10 do të thotë shumë të kënaqur."

Figura 2 tregon ndryshimin në rezultatet e kënaqshmërisë mesatare të jetës midis kuintilit të parë dhe të pestë të të ardhurave në secilin vend.

Ashtu siç pritet, pothuajse në të gjitha vendet, ato në kuintilin e pestë të të ardhurave kanë kënaqësi dukshëm më të lartë se ato në kuintilin e parë të të ardhurave - përjashtime të vetme janë Franca dhe Qipro, ku nuk u gjetën dallime statistike thelbësore.* Është interesante se madhësia e ndryshimit në mesataren e kënaqësisë së jetës midis kuintilit të parë dhe të pestë të të ardhurave ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në vende të ndryshme.

Në Skandinavi, dallimet janë më pak se një pikë, në një shkallë prej njëmbëdhjetë pikëve, ndërsa shumica e vendeve nga Evropa Juglindore dhe Qendrore-Jugore kanë dallime shumë më të mëdha. Dallimi më i madh është 2.55 pikë në Bullgari. Kjo sugjeron që barazia e mirëqenies midis kuintilit të parë dhe të pestë të të ardhurave ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në mes të vendeve evropiane.

Figura 2: Dallimet në kënaqësinë mesatare të jetës në mes të qytetarëve në kuintilin e parë dhe të pestë për të ardhurat totale neto të familjes, sipas vendit



Eksplorimi i marrëdhënies midis mirëqenies së komunitetit dhe të ardhurave


Për të provuar nëse pabarazia në mirëqenien midis segmenteve të shoqërisë me të ardhurat më të larta dhe më të ulëta reflektohet edhe kur merren parasysh aspekte të tjera të mirëqenies, këtu e testojmë nëse ekziston një marrëdhënie e ngjashme midis të ardhurave totale neto të familjes dhe mirëqenies së komunitetit. Dimensioni i mirëqenies në komunitet është përzgjedhur sepse nga analiza jonë është një nga dimensionet që sillen më së ndryshmi nga dimensionet e mirëqenies vlerësuese.

Për të lejuar një analizë më të mirë të decilieve të të ardhurave, kemi grupuar vendet në rajone gjeografike për të rritur madhësinë e mostrës.⁴¹ Figura 3 tregon rezultatet mesatare të standardizuara të mirëqenies së komunitetit për secilin decile të ardhurash (të

ardhurat totale neto të familjes) sipas rajonit. Një trend i ngjashëm mund të shihet në disa rajone, me mirëqenien e komunitetit që arrin kulmin rreth deciljes së dytë ose të tretë të të ardhurave, dhe pastaj mbetet mjaft e sheshtë ose pak në rënie ndërsa të ardhurat rriten.

Megjithatë, shohim tendenca kontradiktore në Skandinavi dhe në Evropën Juglindore. Në Skandinavi, mirëqenia e komunitetit rritet me të ardhura në mënyrë mjaft të qëndrueshme, ndërsa në Evropën Juglindore, mirëqenia e komunitetit arrin kulmin rreth deciljes së katërt të ardhurave, përpara se të pësojë një rënie të ndjeshme gjersa të ardhurat rriten. Marrëdhënia midis të ardhurave dhe mirëqenies së komunitetit nuk duket të jetë po aq e qëndrueshme në të gjitha vendet, sa marrëdhëniet midis të ardhurave dhe kënaqësisë së jetës.

Figura 3: Rezultatet e standardizuara mesatare të mirëqenies së komunitetit, sipas deciljes së të ardhurave dhe rajonit



Përfundime

Pasuria e modulit SSE për Mirëqenien Personale dhe Sociale dhe krahasueshmëria ndërkombëtare e të dhënave të mbledhura, ofrojnë një mundësi të vlefshme për të thelluar të kuptuarit e konceptit të mirëqenies, siç përjetohet në të gjithë Evropën. Kjo broshurë paraqet një mostër të gjetjeve kyçe nga kjo databazë, nga e cila mund të kryhen një rang shumë më i gjerë i analizave. Megjithatë, edhe këto gjetje kryesore sugjerojnë një numër implikimesh fillestare në praktikë dhe për politikë.

Një gjetje kyçe është se mirëqenia duket të jetë një koncept shumëdimensional. Më tej, njerëzit në vende të ndryshme nuk duket se përgjigjen në mënyrë konsistente ndaj pyetjeve që mbulojnë dimensionet të ndryshme të mirëqenies. Dallimet mund të shpjegohen me kontekste të dallueshme kulturore, historike dhe politike; megjithatë, shtytës së politikave të ndryshme mund të kenë ndikim të veçantë në secilën nga dimensionet e mirëqenies. Aty ku është e mundur, analiza duhet të përqipet të shqyrtojë se si këto dimensionet e përgjigjen shtytësve të mirëqenies.

Ndërsa gjetja se familjet me të ardhura më të larta kanë mirëqenie më të lartë se ato me të ardhura më të ulta mund të tingëllojnë intuitive, është e dukshme që madhësia e hendekut të mirëqenies në mes të familjeve me të ardhura të larta dhe të ulëta dallon shumë gjërat të Evropës. Politikbërësit e interesuar për reduktimin e pabarazisë së mirëqenies, si dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme, mund të përqendrohen në përkrahjen shtesë të familjeve në grupet me të ardhura të ulëta.

Kërkohen hulumtime të mëtejshme për të kuptuar pse disa vende kanë një pabarazi më të madhe se të tjerat dhe nëse nga ky krahasim i tillë mund të dalë ndonjë rekomandim politikash. Shqyrtimi i nivelit të korrelacionit në mes të pabarazisë së të ardhurave dhe pabarazisë në mirëqenien do të ishte interesant,

duke pasur parasysh se vendet Skandinave, ku pabarazia e të ardhurave është zakonisht mjaft e ulët, janë gjithashtu në mesin e vendeve me pabarazin më të ulëta të mirëqenies. Marrëdhënia mes të ardhurave absolute dhe pabarazisë të mirëqenies do të meritonte gjithashtu studim, duke pasur parasysh pozicionin e habitshëm të Gjermanisë në figurën 2, e cila megjithë të ardhurat mesatare mjaft të larta, tregon një pabarazi të madhe të mirëqenies mes atyre me të ardhurat më të larta dhe më të ulëta të familjes.

Nuk është gjetur ndonjë lidhje e qëndrueshme midis mirëqenies së komunitetit dhe të ardhurave në nivel rajonal. Kjo gjetje sugjeron që rritja e të ardhurave ose, në të vërtetë, rritja e barazisë së të ardhurave nuk është domosdoshmërisht një qasje efektive për të përmirësuar të gjitha aspektet e mirëqenies. Do të ishte interesante të eksplorohej se pse gjersa të ardhurat në Evropën Juglindore janë duke u rritur, mirëqenia e komuniteteve bie (siç tregohet në Figurën 3). Është gjithashtu interesante të theksohet se Hungaria renditet mjaft mirë në dimensionin e mirëqenies së komunitetit, pavarësisht se renditet shumë më ulët në pesë dimensionet e tjera të mirëqenies (siç tregohet në tabelën 2), pavarësisht gjetjes sonë se rezultatet në dimensionet të ndryshme kanë tendencë të pasqyrojnë gjerësisht njëri-tjetrin.

Hetimi i mëtejshëm rreth rëndësisë relative të secilës prej dimensioneve të mirëqenies të identifikuara në këtë broshurë do të përfaqësonte një kontribut të ri dhe të vlefshëm, si dhe analizë më të hollësishme se si dallohen segmente të ndryshme të popullsisë në aspektin e dimensioneve të ndryshme të mirëqenies. Më tej, krahasimet që përdorin të dhënat e mbledhura për modulën e mirëqenies personale dhe sociale të përfshira në Raundin 3 të SSE do të përfaqësonin gjithashtu një studim të vlefshëm, për të vlerësuar se si trendet e mirëqenies mund të kenë ndryshuar me kalimin e kohës.

Referencat

- Abdallah, S. & Mahony, S. (2012) Stocktaking report on subjective wellbeing. eFrame. <http://www.eframeproject.eu/fileadmin/Deliverables/Deliverable2.1.pdf> [online] [accessed 16th January 2015]
- Bartolini, S. & Bilancini, E. (2010) "If not only GRP, what else? Using relational goods to predict the trends of subjective well-being" *International Review of Economics* 57:199-213.
- Berry, C. (2014) Wellbeing in four policy areas: Report by the All-Party Parliamentary Group on Wellbeing Economics. London: New Economics Foundation.
- Easterlin, R. A. (2013) 'Happiness and Economic Growth: The Evidence'. IZA Discussion Paper No.7187.
- European Commission (2013) Quality of life in Europe: Subjective Wellbeing. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- European Union. (2006) Strategy for Sustainable Development [webpage]. Retrieved from http://europa.eu/legislation_summaries/environment/sustainable_development/128117_en.htm
- Huppert, F.A. & So, T. (2009) What percentage of people in Europe are flourishing and what characterises them? Briefing document for the OECD/ISQOLS meeting Measuring subjective well-being: an opportunity for NSOs? 23/24 July, 2009, Florence, Italy.
- Kersley, H. & Shaheen, F. (2014) Addressing economic inequality at root: 5 goals for a fairer UK. London: New Economics Foundation.
- Layard, R. (2005). Happiness: Lessons from a New Science. New York: Penguin.
- OECD (2006). Going for Growth 2006. Paris: OECD Publications
- United Nations (2013) Inequality matters: Report of the World Social Situation 2013. New York: United Nations.
- Vittersø, J., Soholt, Y., Hetland, A., Thorsen, I. A., & Røysamb, E. (2010). "Was Hercules happy? Some answers from a functional model of human well-being *Social Indicators Research* 95:1-18.
- Wilkinson, R. G., & Pickett, K. (2011). The spirit level. Tantor Media, Incorporated.

Shënimet përfundimtare

ⁱ SSE6 -2012 Edicioni 2.1, publikuar me 26 Nëntor 2014, SSE www.europeansocialsurvey.org

ⁱⁱ Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Islanda, Irlanda, Izraeli, Italia, Kosova, Lituania, Hollanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Federata Ruse, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar

ⁱⁱⁱ Informacione të mëtejshme metodologjike rreth Sondazhit Social Evropian janë në dispozicion në www.europeansocialsurvey.org.

^{iv} Është aritur duke përdorur procedura të standardizuara të përcaktuara nga Ekipi Shkencor Kryesor i SSE

^v Nëse nuk shprehet ndryshe, analizat bazohen në mostrën e plotë të rreth 54,600 të anketuarve. Peshat e dizajnit të SSE janë aplikuar për analiza në nivel vendi; Si dizajni ashtu edhe pesha e popullsisë janë aplikuar për analizën në nivel rajonal.

^{vi} Ne kemi përdorur "principal component analysis" - rotacioni Varimax. Kjo është një teknikë që mund të përdoret për të parë se cilat grupe të pyetjeve në një sondazh lidhen më së shumti me njëri-tjetrin statistikisht dhe për këtë arsye formojnë grupime.

^{vii} Këto rezultate janë nxjerrë duke llogaritur së pari një rezultat të z-së të standardizuar për secilin pyetje në një dimension. Një rezultat zero i z-së do të thotë një vlerë që është e barabartë me mesataren dhe një rezultat një ose një negative, do të thotë një distancë e një devijimi standard nga mesatarja. Pastaj kemi nxjerr mesataren rezultateve të z-së për secilin pyetje me z-rezultatet për të gjitha pyetjet e tjera për një dimension, për të prodhuar një rezultat të përgjithshëm të standardizuar për çdo dimension.

^{viii} Përdorimi i Ndarësit (sortuesit) të Microsoft Excel

^{ix} Peshat optimale u gjetën të ishin: Mirëqenia emocionale (2.97), Funksionimi (0.78), Mirëqenia e Komunitetit (0.00), Marrëdhëniet Mbështetëse (0.86) dhe Vitaliteti (0.00)

^x Në prag $p = 0.05$ (2-bisht) - megjithëse rezultatet e Francës ishin pak më lart se ky prag në $p = 0.054$

^{xi} UK & Ireland përfshin Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën. Skandinavia përfshin Danimarkën, Finlandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Islandën. Evropa Jugore përfshin Qipron, Portugalinë, Spanjën dhe Italinë. Evropa Perëndimore përfshin Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Holandën dhe Zvicrën. Evropa Qendrore dhe Lindore përfshin Estoninë, Hungarinë, Poloninë, Sllovakinë, Slloveninë, Lituania dhe Republikën Çeke. Evropa Juglindore përfshin Bullgarinë, Shqipërinë dhe Kosovën. Izraeli, Federata Ruse dhe Ukraina nuk u përfshihen në këto rajone, kështu që janë përjashtuar nga kjo analizë.

Rreth ESS

Sondazhi Social Evropian është një Konzorcium Evropian për Infrastrukturën e Kërkimeve të (SSE ERIC), i cili siguron të dhëna të hapura ndërkombëtare mbi qëndrimet dhe sjelljet publike gjatë kohës. SSE është një studim i drejtuar akademikisht që është zhvilluar në të gjithë Evropën që nga viti 2001. Databaza përmban rezultatet e rreth 350,000 intervistave të kryera çdo dy vjet me mostrat e përzgjedhura rishtazi, mostër ndërkombëtare. Anketa mat qëndrimet, besimet dhe modelet e sjelljes të mostrave të ndryshme në më shumë se tridhjetë kombe.

Temat e SSE:

- Besimi në institucione
- Angazhimi politik
- Vlera socio-politike
- Vlera morale dhe shoqërore
- Kapitali shoqërorë
- Përrjashtimi shoqërorë
- Identiteti kombëtar, etnik dhe fetar
- Mirëqenia, shëndeti dhe siguria
- Përbërja demografike
- Edukimi dhe profesioni
- Gjendja financiare
- Gjendja e familjes
- Qëndrimet ndaj mirëqenies
- Besoni në drejtësinë penale
- Shprehjet dhe përvojat e moshës
- Qytetaria, përfshirja dhe demokracia
- Imigrimi
- Familja, puna dhe mirëqenia
- Morali ekonomik
- Organizimi i rrjedhës së jetës

Zbuloni më shumë rreth SSE ERIC dhe qasuni në të dhëna në www.europeansocialsurvey.org

Zbuloni më shumë rreth nivelit të mirëqenies në Evropë në një faqe interneti të krijuar posaçërisht nga SSE www.esswellbeingmatters.org

Ndiqni SSE në Twitter @ESS_Survey

Ndiqni SSE në Facebook @EuropeanSocialSurvey



Ky publikim ka marrë fonde nga Programi për Hulumtim dhe Inovacion i Horizonti 2020 i Bashkimit Evropian nën marrëveshjen e grantit 676166.

Botuar nga Sondazhi Social Evropian ERIC
City, University of London
Northampton Square, London
EC1V 0HB, United Kingdom
+44 (0)20 7040 4901
Korrik 2017
Dizajni origjinal nga Rapidity

SSE i'u dha statusi i Konzorciumit për Infrastrukturë për Hulumtime Shoqërore Evropiane (ERIC) në vitin 2013. Gjatë raundit 7 (2014), SSE ERIC kishte 14 anëtarë dhe 2 vende vëzhguese.

Anëtarët:

Austria, Belgjika, Republika Çeke, Estonia, Franca, Gjermania, Irlanda, Lituania, Holanda, Polonia, Portugalia, Slovenia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar.

Vëzhguesit:

Norvegji, Zvicër.

Pjesëmarrës të tjerë:

Danimarkë, Finlandë, Hungari, Izrael, Letoni, Slovaki dhe Spanjë.

Grupet këshillimore shumëkombëshe në Asambleshë e Përgjithshme të SSE ERIC janë Bordi Këshillimor për Metodatat (MAB), Bordi Këshillimor Shkencor (SAB) dhe Komiteti i Financave (FINCOM). Selia Qendrore e SSE ERIC, ku është vendosur Drejtori i saj (Rory Fitzgerald), ndodhet në City, Universitetin e Londrës. Ekipi Ekzekutiv i Ekspertit Qendror i SSE ERIC përfshin GESIS - Instituti Leibniz për Shkencat Sociale (Gjermani); Katholieke Universiteit Leuven (Belgjikë); NSD - Qendra Norvegjeze për të Dhëna Kërkimore (Norvegji); SCP - Instituti Holandez për Kërkime Sociale (Holandë); Universitat Pompeu Fabra (Spanjë); Universiteti i Lubjanës (Sloveni). Forumi i Koordinatorëve Kombëtar (NO) përfshin NCS të SSE nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

